



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës

01.Nr. 670/01-2321 /24
Kaçanik, 23.01.2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr. 400/03-24314/23 si dhe nenit 14, 15 të Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për Ndarjen e Bursave dhe Caktimin Kriterëve për Vitin Akademik 2023-2024

1. Me këtë Vendim caktohen kushtet për aplikim, kriteret e përzgjedhjes, kohëzgjatja e realizimit të bursave, lartësia dhe numri i përfituesve të bursave.
2. Për vitin akademik 2023-2024, Komuna e Kaçanikut ndan 50 bursa për student të studimeve themelore universitare, në shumën 50 € në muaj (për 10 muaj).
3. Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kriterë:
 - 3.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
 - 3.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës,
 - 3.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
 - 3.4 të jenë student të vitit të dytë e më lartë,
 - 3.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
 - 3.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Makineri dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor).
4. Nga një familje mund të përfitoj vetëm një student, ndërsa përfitues do të jetë ai student që ka notën mesatare më të lartë.
5. Studentët të cilët i plotësojnë kriteret nga pika 3 e këtij vendimi, gjatë aplikimit duhet t'i paraqesin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Rregulloren Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtyre kriterëve:

6.1 Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10,

6.2 Studentët e drejtimeve deficitare nga pika 3.6 përfitojnë 5 pikë,

6.3. Studentët të cilët i takojnë kategorive të dala nga lufta (fëmijët e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve të luftës), u shtohen 2 pikë,

6.4 Studentët me gjendje të rëndë ekonomike dhe studentë me aftësi të kufizuara, u shtohen 2 pikë dhe

6.5 Dy e më shumë studentë nga një familje, u shtohen 1 pikë.

7. Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

8 . Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset: Drejtoria e Arsimit.

9. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Arkiva.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01.Nr. 104/02-2964/24
Kaçanik:30.01.2024

Në bazë të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës, merr këtë :

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT ORGANIZATIV KOMUNAL PËR KREMTIMIN E 17 SHKURTIT- FESTA E SHPALLJES SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

1. Me këtë vendim themelohet këshilli organizativ komunal për kremtimin e 17 Shkurtit-Festa e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, me anëtarët si në vijim :
 1. Sabedin Vishi-koordinator i këshillit
 2. Përfaqësuesi nga Shoqatat e Dalura nga Lufta e UÇK-së -anëtarë
 3. Hafize Sallahi – anëtare
 4. Izahir Doda – anëtarë
 5. Dardana Tafili – anëtare
 6. Fatlume Guri – anëtare
 7. Ismail Murseli – anëtarë
 8. Fatmir Çaka – anëtarë
 9. Fatos Vishi – anëtarë
2. Përbërja e këtij këshilli është bërë në formën që të ketë gjithëpërfshirje të të gjithë akterëve të cilët mund të kontribuojnë në kremtimin e përvjetorit.
3. Detyrat kryesore të këshillit janë që të organizojnë takime dhe të përzgjedhin formën më të mirë të shënimit të kësaj dite shumë të rëndësishme, përsfhirë programin artistik, organizimin, orarin, ftesat, qështjet teknike, sportin etj.
4. Mandati i këshillit si në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon me rastin e shënimit të kësaj dite , gjegjësisht më 19.02.2024.
5. Ky vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit të tijë.

I dërgohet :
Anëtarëve,
Arkivit

Kryetari i Komunës
Besim Hazi